

VENDIM
Nr. 28, datë 20.6.2019

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË UJËSJELLËS-KANALIZIME FUSHË-ARRËZ SHA

Në mbështetje të nenit 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar (ligji nr. 8102), VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë” (VKM nr. 958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009 “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, e ndryshuar (rregullore e licencimit),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 20.6.2019, pasi shqyrtoi çështjen me objekt: “Mbi miratimin e projektvendimit: ‘Për licencimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Fushë-Arrëz sh.a.’”,

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Fushë-Arrëz (UK Fushë-Arrëz), me shkresën nr. 56 prot., datë 9.5.2019 ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU), kërkesën për licencim për shkak të mbarimit të afatit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit të UK Fushë-Arrëz në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-së nr. 958 dhe rregulloren e licencimit.

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:

a) Shoqëria UK Fushë-Arrëz ofron shërbimin e furnizimit me ujë për 4349 banorë dhe shërbimin e largimit e ujërave të ndotura për 1320 banorë, në Bashkinë Fushë-Arrëz si më poshtë:

- Zona e shërbimit me furnizim me ujë nga shoqëria UK Fushë-Arrëz:

Nr.	Njësitë administrative të Bashkisë Fushë-Arrëz	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të njësive administrative	Popullsia e shërbyer
1	Fushë-Arrëz	Qyteti Fushë-Arrëz	3821
		Fshati Fushë-Arrëz	528
TOTALI			4349 banorë

Shënim: Pjesa tjetër e njësive administrative nuk mbulohen me shërbimin e furnizimit me ujë nga UK Fushë-Arrëz.

- Zona e shërbimit me kanalizime nga shoqëria UK Fushë-Arrëz:

Nr.	Njësitë administrative të Bashkisë Fushë-Arrëz	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të njësive administrative	Popullsia e shërbyer
1	Fushë-Arrëz	Qyteti Fushë-Arrëz	1103
		Fshati Fushë-Arrëz	220
TOTALI			1320 banorë

Shënim: Pjesa tjetër e njësive administrative nuk mbulohen me shërbimin e kanalizimeve nga UK Fushë-Arrëz.

b) Drejtuesi teknik i shoqërisë z. Anduel Gjinaj, mban titullin: “Master Shkencor në Inxhinieri Gjeomjedi” marrë në maj 2017.

4. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit, ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Fushë-Arrëz, të:

a) kërkesave të ligjit nr. 8102 si dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si aftësi tekniko-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar (ligji nr. 9121) për mos lejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve;

5. ERRU-ja, në bazë të vlerësimit dhe verifikimeve të kërkesës së shoqërisë UK Fushë-Arrëz, rekomandon:

- Shoqëria UK Fushë-Arrëz, duhet të aplikojë pranë ERRU-së, për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura;

- Shoqëria UK Fushë-Arrëz, duhet të punojë në drejtim të zgjerimit të zonës së shërbimit, në mënyrë që të gjithë banorët e Bashkisë Fushë-Arrëz të marrin shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura nga kjo shoqëri me cilësi dhe brenda standardeve.

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Fushë-Arrëz është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Fushë-Arrëz sh.a. me NUIS: K19629304M në kategoritë:

a) Kategoria A - Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;

b) Kategoria C - Për largimin e ujërave të ndotura.

2. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Fushë-Arrëz sh.a., autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:

a) Drejtues ligjor: Xhon Leka;

b) Drejtues teknik: Anduel Gjinaj.

3. Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Fushë-Arrëz sh.a., është:

Njësia Administrative Fushë-Arrëz: Qyteti Fushë-Arrëz

Fshati Fushë-Arrëz.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare.

5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Fushë-Arrëz sh.a. detyrohet të nënshkruajë Kushtet e Licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.

6. Ngarkohet Drejtoria Tekniko-Ekonomike të njoftojë shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Fushë-Arrëz sh.a. për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani